


Raporti Vjetor 2015

mbi Gjendjen e Filantropise

SHQIPËRIA

Pasqyrë e Fakteve



85

e rasteve të identifikuara



4.41
milion euro

vlera e përgjithshme e donacioneve



1.6 €

mesatarja e dhurimit për qytetar




252.8%

rritja e dhurimit nga individë/ publiku i gjerë

Gjatë vitit 2015, Catalyst Balkans ka monitoruar artikujt e mediave mbi dhurimet filantropike të individëve, korporatave dhe diasporës në Shqipëri. Kjo broshurë paraqet statistikatat bazë të gjetjeve gjatë hulumtimit.

DONATORËT

DONACIONET SI LASLLOJIT TË DONATORËVË
(% e rasteve vs. shumës së regjistruar)



TRENDET KRYESORE PËR
LLOJET E DONATORËVË -
2014 - 2015*

	% E RASTEVE		% E SHUMËS SË IDENTIFIKUAR	
	2014	2015	2014	2015
Sektori i Biznesit	14.6%	11.8%	45.8%	8.9%
Publiku i Gjerë	31.7%	60.0%	4.0%	59.1%
Individë	19.5%	9.4%	49.4%	5.4%

*Dallimet e konsiderueshme mes dy viteve janë të ilustruara në faqen që vijon.

GJETJET KRYESORE:



- Në vitin 2015, llojet më aktiv të donatorëve sipas numrit të identifikuar të dhurimeve ishin publiku i gjerë (60.0%), i ndjekur nga sektori i biznesit (11.8%) dhe individët (9.4%). Donatorët e tjerë duke përfshirë kategorinë e përzier (më shumë se një kategori donatori të përfshirë në të njejtin donacion), shoqatat dhe komunitetet fetare. Numri i përgjithshëm i këtyre rasteve është 18.8%.
- Duke vëzhguar llojet e donatorëve nga prizmi i shumës së dhurimeve, pamja është e njejtë: dhurimet nga publiku i gjerë prijnë me 59.1% të vlerës së përgjithshme, i ndjekur nga sektori i biznesit me 8.9%, dhe individët me 5.4%. Përqindja e donatorëve të tjerë është 26.6%, kryesisht nga shoqata të ndryshme.
- Kur analizojmë dhurimet nga diaspora, përqindja e rasteve që janë identifikuar është vetëm 1.2%, përderisa vlera e dhurimeve për këtë vit nuk është identifikuar.
- Në përgjithësi, ekzistojnë disa devijime në lidhje me të dhënat e dhurimit në vitet 2014 dhe 2015, të cilat mund të shpjegohen përmes disa faktorëve:
 - Rritje e konsiderueshme në vlerën e identifikuar të donacioneve, kjo për arsye se metodologjia jonë e mbledhjes dhe e konfirmimit të të dhënave është përmirësuar.
 - Vlera e pazakontë e këtij viti e mesatares së dhurimit për qytetar paraqitet si pasojë e fushatave për trajtime mjeksore për fëmijët, të cilat morën një përkrahje të madhe në të gjithë Shqipërinë.
 - Rëniet në dhurime nga individë të njohur vjen si pasojë e investimeve të vogla në vitin 2015. Në vitin 2014, kishte disa raste të dhurimeve të mëdha nga individë të njohur të cilët iu përgjigjën kërkesave të popullsisë që jetonin me vështirësi ekonomike në lidhje me nëvojat për shtëpi banimi.



SEKTORI I BIZNESIT

Profilët e Llojit më të Shpësthtë të Donatorëve



Individë/
Familje

Institucione

TOP 3
SUBJEKTET PËRFITUESE

40.0%

30.0%

20.0%

Organizata
Jo-fitimprurëse



Mbështetje për
Grupet e
Margjinalizuara

Përkujdesje
Shëndetësore

TOP 3
QËLLIMI I DHURIMIT

30.0%

30.0%

20.0%

Menaxhimi i
Emergjencave



Persona nga
Zonat Gjeografike
Specifike

Fëmijë/
Të Rinjtë pa
Përkujdesje
Prindërore

TOP 3 GRUPET PËRFITUESE
PËRFUNDIMTARE

40.0%

30.0%

20.0%

Persona me
Probleme
Shëndetësore



SHEMBUJ TË DONACIONEVE NGA SEKTORI I BIZNESIT

Tirana Bank ka “adoptuar” tre fëmijë nga Fshatërat SOS në Shqipëri, duke shprehur angazhimin për të mbuluar të gjitha shpënzimet e tyre gjatë gjithë kohës që ata do të qëndrojnë në SOS Fshatërat e Fëmijëve në Shqipëri.

Duke përdorur kartat e tyre të kredit, klientët e *Alfa Bankës në Shqipëri* kanë mbështetur fushatën e kësaj banke për të ndihmuar gratë që janë diagnostikuar me kancer të gjirit. Ndërkohë që kjo fushatë po rritë ndërgjegjësimin rreth kësaj çështjeje në Shqipëri, një donacion prej 25,000 EUR do të përdoret për mbështetjen psiko-sociale të grave.

Telekom Albania zhvilloi një aksion interesant të shpërndarjes së 20 iPad-ëve për fëmijët të cilët janë duke u mjekuar në repartet e hematologjisë dhe onkologjisë në Spitalin e Tiranës. Kjo dhuratë do t’ju mundësojë fëmijevë të kryejnë detyrat e tyre shkollore dhe të ndjekin mësimet e tyre dhe gjithashtu do t’u sigurojë edhe zbatimje.

Mbështetje Gjatë Përmbytjeve në Shqipëri

Sektori i biznesit ka qenë shumë i përfshirë në sigurimin e mbështetjes për familjet e prekura nga përmbytjet në Shqipëri. Ndaj, *Telekom Albania* ka dhuruar pajisje elektrike, ndërsa kompania *Albpetrol* ka shpërndarë ushqim dhe veshëmbathje.

Dy shembuj të tjerë interesant lidhur me dhurimin në rastin e përmbytjeve vjen nga Fondacioni *Vodafone* në Shqipëri dhe *Philip Morris*.

Philip Morris, në bashkëpunim me *Young Women’s Christian Association* (YWCA), kanë dhuruar bagëti me vlerë 80,000 USD për familjet e prekura nga përmbytjet në Fier.

Fondacioni Vodafone ka dhuruar pako me ndihma për 500 familje të prekura nga përmbytjet në Vlorë dhe Fier; gjithashtu, ata nuk u ndalën me aq, por nisën fushatën *Red Alert* e cila do të informojë të gjithë klientët e *Vodafonë* për katastrofat natyrore në të ardhmen dhe do t’ju mundësojë atyre të dhurojnë donacione me SMS përmes numrave special.



PUBLIKU I GJERË

Profilat e Llojit më të Shpësthtë të Donatorëve



Individë/
Familje

Organizatrat
Jo-fitimprurëse

TOP 3
SUBJEKTET PRANUESE

84.3%

5.9%

3.9%

Institucione



Zbutje e
Varfërisë

Përkujdesje
Shëndetësore

TOP 3
QËLLIMI I DHURIMIT

31.4%

27.5%

21.6%

Mbështetje për
Grupet e
Margjinalizuara



Persona me
Vështirësi
Ekonomike

Fëmijë/Të Rinjtë
pa Përkujdesje
Prindërore

TOP 3 GRUPET PËRFITUESE
PËRFUNDIMTARE

33.3%

11.8%

9.8%

Persona me Af-
tesë të Kufizuara/
Persona nga
Zona të Veçanta
Gjeografike



SHEMBUJ TË DHURIMIT NGA PUBLIKU I GJERË

Aktorët e Teatrit Kombëtar në Tiranë hapën një llogari bankare të veçantë dhe nisën një fushatë duke apeluar tek publiku dhe sektori i biznesit për ndihmë. Qëllimi kryesor i fushatës ishte mbledhja e fondeve për rinovimin e Teatrit Kombëtar, i cili është në gjendje mjaft të rëndë.

*Një event i pazakonshëm i mbledhjes së fondeve u organizua nga Hotel Rogner në Tiranë. **Një çift gay ka udhëtuar nga Londra në Shqipëri** për t'u martuar pikërisht në ditën ndërkombëtare kunder Homofobisë. Pjesmarrësit në ceremoninë e dasmës u ftuan të japin donacione për hapsirën e sigurtë të pjestarëve të komunitetit LGBT në Shqipëri.*

*Maratona vjetore e organizuar nga Organizata jo-fitimprurëse **Medical Response of the Diplomatic Corps**, në bashkëpunim me **Vodafone Albania**, ka mbledhur fonde në vitin 2015 për Spitalin Pediatrik të Tiranës, në mbështetje të kujdesit dhe trajtimeve mjeksore të fëmijevë me kancer.*


Mbështetja Gjatë Përmbytjeve

Në vitin 2015, u organizuan një seri aksionesh kolektive të cilat mobilizuan grupe individësh për të siguruar mbështetje për shumë familje nga disa rajone të Shqipërisë të cilat ishin prekur nga përmbytjet.

*Disa shembuj përfshijnë: **Komuniteti Musliman Shqipëtar** shpërndau pako ushqimore; **Klubi i Motoçiklistëve Steel Wings** mblodhi dhe shpërndau furnizime të nevojshme për familjet e prekura nga përmbytjet në Vlorë dhe Fier; **Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)** mblodhi 2 ton ushqime nga qytetarë të ndryshëm; **Kryqi i Kuq në Shqipëri** siguroi ushqim, veshëmbathje dhe furnizime të tjera për mbi 4,500 familje.*

PËRDORIMI I DONACIONEVE

PËRDORIMI I DONACIONEVE (sipas % së rasteve)



Të dhënat për Shqipërinë lidhur me përdorimin e donacioneve tregojnë se 70.6% e rasteve të identifikuara janë mbështetje njëherëshe (ndihmë humanitare, trajtime mjeksore për individë, shtëpi banimi për individë). Një përqindje shumë e vogël prej 15.3% shkon për mbështetje të cilat mund të rezultojnë me efekte afatgjata (investime kapitale, pajisje, bursa studimesh dhe të ngjashme). Ky numër dhurimesh është paksa më e vogël kur e krahasojmë me dhurimet në vendet e tjera të rajonit. Sektori i biznesit, ashtu si edhe në vendet e tjera të rajonit, ka treguar interes më të madh për dhurime strategjike: 30% e donacioneve të tyre janë ato më potencial më të madh për të rezultuar me efekte afatgjata, përdërisa mbështetja e qytetarëve për dhurime strategjike rezulton vetëm 9.8%.



SHEMBUJ TË DHURIMEVE STRATEGJIKE

Telekom Albania ka dhuruar pajisje të nëvojshme mjeksore për qendrat shëndetësore në Theth dhe Razme, duke kontribuar në modernizimin e pajisjeve mjeksore në këto komunitete.

TRENDET E SHFRYTZIMIT TË DONACIONEVE – 2014 - 2015 (% e Rasteve)

	2014		2015
Mbështetje afatgjatë	31.7%	↘	15.3%
Mbështetje një-herësh	26.8%	↗	70.6%
Të panjohura	41.5%	↘	14.1%

QËLLIMET KRYESORE TË DHURIMIT

30.6%

ZBUTJE E
VARFËRISE

27.1%

MBËSHTETJE
PËR GRUPET E
MARGJINALIZUARA

17.6%

PËRKUJDESJE
SHËNDETËSORE

15.3%

MENAXHIMI I
EMERGJENCAVE

QËLLIME TË TJERA TË DHURIMIT (sipas % së rasteve)

0 - 2%

- Zhvillim i Komunitetit
- Sport
- Dhurime Sezonale

2 - 5%

- Edukim
- Kulturë dhe Art

TRENDET NË ARSYET
KRYESORE TË DHURIMIT -
2014 - 2015 (% e Rasteve)


2014

2015

Mbështetje për Gr. e Margjinalizuara	43.9%	↘	27.1%
Zbutje e Varfërisë	9.8%	↗	30.6%
Përkujdesje Shëndetësore	14.6%	↗	17,6%
Edukim	4.9%	↘	2.4%
Menaxhim i Emergjencave	2.4%	↗	15.3%

SUBJEKTET PRANUESE

LLOJET E SUBJEKTEVE PRANUESE



Në vitin 2016, pranuesit më të shpesht të dhurimeve ishin individët dhe familjet (76.5%). Institucionet radhiten si destinacioni i dytë më i shpeshtë i dhurimeve (10.6%). Organizatat jo-fitimprurëse kanë pranuar 8.2% të dhurimeve, edhe pse kjo përqindje është rritur në krahasim me të dhënat mbi dhurimet e identifikuara në vitin 2014.

Pranuesit shtetërorë përfshijnë institucionet dhe qeveritë vendore dhe qendrore. 11.8% e rasteve të dhurimit janë identifikuar si dhurime për shtetin, përqindje kjo dukshëm në rënie në krahasim me vitin 2014.

SUBJEKTET PËRFITUESE (% e Rasteve)	2014		2015
Institucione	39.1%	↘	10.6%
Organizata Jo-fitimprurëse	4.9%	↗	8.2%
Individë / Familje	34.1%	↗	76.5%
Qeveritë Vendore/Qendrore	7.3%	↘	1.2%

GRUPET PËRFITUESE KRYESORE

31.8%

PERSONA ME
VËSHHIRËSI
EKONOMIKE

20.0%

PERSONA
NGA RAJONE
GJEOGRAFIKE
SPECIFIKE

16.5%

PERSONA ME
PROBLEME
SHËNDETËSORE

10.6%

FËMIJË / TË RINJ
PA PËRKUJDESJE
SHËNDETËSORE

PËRQINDJA E GROPEVE TË TJERA PËRFITUESE (% e Rasteve)

Më pak se 5%

- Publiku i Gjerë
- Popullsia rezidente në shtete të tjera
- Minoritetet
- Komuniteti LGBT
- Gratë dhe Fëmijë të mbijetuar të dhunës
- Refugjatë dhe persona të zhvendosur
- Të moshuar

5 – 10%

- Persona me aftësi të kufizuara

TRENDET NË GRUPET
KRYESORE TË PËRFITUESVE
PËRFUNDIMTAR
(% e rasteve të regjistruara)

	2014		2015
Persona me vështirësi ekonomike	14.6%	↗	31.8%
Persona me probleme shëndetësore	14.6%	↗	16.5%
Fëmijë / Të Rinj pa përkujdesje shëndetësore	24.4%	↘	10.6%
Persona me Aftësi të kufizuara	9.8%	↘	8.2%
Persona nga zonat gjeografike specifike	2.4%	↗	20.0%

Hulumtimi u krye nga:

°catalyst

Hulumtimi u mbështet nga:

B | T | D The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

M
CHARLES STEWART
MOTT FOUNDATION

Raporti Vjetor mbi Gjendjen e Filantropisë në Shqipëri – Pasqyrë e Fakteve është pjesë e një iniciative më të gjërë të promovimit dhe nxitjes së filantropisë në rajon, krijuar nga Fondacioni Catalyst. Hulumtimet themelore dhe ky publikim janë përpiluar nga Fondacioni Catalyst (Catalyst Balkans) dhe me mbështetjen bujare të Fondacionit Mott C.S dhe Balkan Trust for Democracy (BTD).

Opinionet e shprehura në këtë publikim nuk janë domosdoshmërisht opinionet e Balkan Trust for Democracy dhe German Marshall Fund e United States, apo të partnerëve të saj.

Duke marrë parasysh që vlera e donacioneve në Shqipëri ishte raportuar vetëm në 4.7% të rasteve, vlerësimi për vlerën e përgjithshme të dhurimit është bërë përmes ekstrapolimit duke u bazuar në të dhënat e njohura.

www.catalystbalkans.org

PËRGATITUR NGA:
Aleksandra Vesic

REDAKTORËT:
Aleksandra Vesic
Nathan Koeshall

Dizajni Grafik:
Tatjana Negic Paunovic

CATALYST BALKANS
Takovska 38,
11000 Beograd
Serbi

www.catalystbalkans.org

Beograd, 2016